UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"
Prizren
SENATI

Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Univerzitet Prizrena
"UKSHIN HOTI"
Pranuar me dt. 12.06.2020
Zyra e pranimit 308
Nr. i protokolit 01-132

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref.: Prizren, më: 11.6.2020

Mbështetur në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, me nr. 04-V-621 të datës 30 Maj 2013, Senati i Universiteti, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 11.6.2020, mori këtë:

# VENDIM

Plotësim- ndryshim i vendimit të datës: 21.4.2020 me nr.prot: 01-112

I. Sistemi antiplagjiat do të fillojë të zbatohet prej datës 1 Tetor 2020 përmes Sistemit të SMU-së;

II. Shërbimet të cilat do të kryhen përmes sistemit të kontrollit të antiplagjiaturave do të jenë: punimet e diplomës BSC, MSC dhe PhD, punimet e profesorëve, punimet shkencore të cilat publikohen në revistat e Universitetit etj.

III. Punimet e Diplomës BSC, MSC dhe PhD mund t'i kontrollojnë studentët dhe profesorët;

IV. Me vendim të veqantë, këto punime mund t'i kontrolloj edhe një Komision prej tre anetarësh i formuar nga Rektori, kur konsiderohet e nevojshme ne rast të ndonjë ankese ose dyshimi të bazuar për keqpërdorim. Komisioni do të përpilojë procesverbal me rastin e kontrollit;

V. Sistemi i instaluar, do të bëjë kontrollimin e punimeve në dy mënyra:

Mënyra online: ku do të kërkohet në shfletuesit dhe makinat kërkimore, për punime të ngjashme dhe do ta identifikoj secilën pjesë nëse është kopjuar apo tentohet të bëhet plagjiaturë. Sistemi do të saktësoj secilën pjesë të punimit se ku është kopjuar apo nga është marrë dhe atë do ta paraqesë me përqindje.

Kontrolli i punimit të diplomës, punimeve shkencore ndërmjet Universitetit brenda sistemit. Mënyra e kontorllit në bazë të të dhënave, ku punimet e studentëve, profesorëve, do të kontrollohen edhe me punimet paraprake të cilat janë dorëzuar dhe verifikuar në sistem, nga data: 1 Tetor, 2020.

VI. Ngjashmëria e punimit mbi 20% për Studimet Master dhe 30% për Studimet BSC, me ndonjë punim tjetër konsiderohet plagjiat.

VII. Studentet dhe profesoret janë te obliguar që të përdorin konfirmimin e sistemit para procedimit të mëtutjeshëm;

VIII. Obligohet Zyra e IT-së dhe operatori ekonomik, të ju krijoj qasje profesoreve dhe Studentëve në sistemin e SMU-së.

IX. Operatori ekonomik të dorëzojë një udhëzues për përdorimin e sistemit;

X. Vendimi hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit, ndërsa sistemi do të fillojë të zbatohet, prej datës: 1 Tetor 2020.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Anëtarëve të Menaxhmentit;
2. Njësive akademike;
3. Sekretarit të Përgjithshëm;
4. IT, web dhe SMU;
5. Arkivit.

Kryesues i Senatit ,

Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj